



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:089597

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01507213

C.nr.1013/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Alban Beqiri në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditësit A.Z.nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim av.Burhan Qosaj nga Ferizaj, kundër të paditurës B.E.me seli në Prishtinë në Rr.”.....” Lagja të cilën e përfaqëson me autorizim av.Gazmend Nushi me objekt kontesti kompenzim dëmi, në seancën shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 12.10.2020, mori, kurse me datën 26.10.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht kërkesëpadia e paditësit A.Z.nga Ferizaj, si e bazuar.
- II. DETYROHET** e paditura B.E.me seli në Prishtinë Rr.”.....”Lagjaqë paditësit në emër të kompenzimit të dëmit të shkaktuar t`ia paguaj shumën e përgjithshme prej 27.738,00€ (njëzet e shtatë mijë euro e shtatëqind e tridhjetë e tetë euro), për periudhën kohore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, me kamatën ligjore prej 8 %, nga data 12.10.2020, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.768€, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.
- III. DETYROHET** e paditura B.E.me seli në Prishtinë të rregulloj kanalizimin dhe të bëjë pastrimin e mbeturinave, të largoj sasinë e dheut që e ka vendosur në pjesën e NK.nr.145-0, përmes të cilës është bërë edhe bllokimi i kanalizimit që kalon nëpër pjesën e NK.nr.891-0 ZK Babush i Serbeve, të gjitha brenda afatit prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.
- IV. REFUZOHET** pjesa tjetër e kërkesëpadisë të paditësit mbi lartësinë e shumës

të aprovuar në pikën një (II) të dispozitivit që ka kërkuar paditësi që për çdo vit në të ardhmen në për periudhë prej 99 vite të **DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën nga 9.246,00€, si e pa bazuar.

V. DETYROHET paditësi që të bëjë pagesën e diferencës në emër të takës gjyqësore për padi në shumë prej 80€.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit në fjalën e tij ka deklaruar se edhe më tutje mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndryshmit të saj duke shtuar se nga provat e administruara, dhe atë ekspertizës së bërë nga eksperti gjeodezisë dhe ai i vlerësimit të dëmit është vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, pasi që e paditura me veprimet e saj e ka bllokuar kanalizimin përmes të cilës i është shkaktuar dëme i konsiderueshëm material paditësit në pronat e tij i cili fakt vërtetohet edhe nga provat materiale-fotot të cilat pjesë e shkresave të lëndës.

Se e paditura e ka shkaktuar dëmin në pronat e paditësit kjo është vërtetuar përmes procesverbalit ku Inspektorati i Komunës së Ferizaj 01 nr. 355/036 dt.26.03.2018, ka urdhëruar të paditurën që të eliminoj, sanoj dëmin e shkaktuar të cilin gjë nuk e ka bërë si dhe kjo është vërtetuar edhe përmes ekspertizës së gjeodezisë është vërtetuar fakti se dëmi që i shkaktuar paditësit ka ardhur me veprimet e të paditurës pasi që si rrjedhojë që e paditura e ka dëmtuar kanalizimin në atë pjesë ku parcelat e paditësit gjenden ashtu që pronat e paditësit janë dëmtuar në atë shkallë sa që pa rregullimin e saj-kanalizimit dhe pastrimin e mbeturinave të hedhura nga ana e të paditurës parcelat e paditësit objekt shqyrtimit sipërfaqja e dëmtuar si në ekspertizë është e dëmtuar në vazhdimësi ku për pasojë mund të ketë edhe dëmtime të vazhdueshme edhe në pjesë tjetër të sipërfaqes së tokës, e të cilat janë po ashtu të paditësit.

Kurse lartësi e dëmit material ka theksuar se është vërtetuar përmes ekspertizës së vlerësimit të pronës ku eksperti ka konstatuar se paditësi për çdo vite i shkaktohet dëme material në shumë prej 9.246 euro, për shkak se të njëjtat nuk mund ti punoj-mbjell në rast se eventualisht nuk rregullohet kanalizimit

Andaj ka kërkuar nga ana e gjykatës që ta aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ta detyroj të paditurën që paditësit në emër të dëmit ti kompensoj shumën prej 9.246 euro në vit si dhe ta obligoj të paditurën që në afat prej 15 dite pas pranimit të aktgjykimit ti marr të gjitha veprimet teknike, fizike dhe ta rregulloj – sanoj kanalizimin duke i pastruar nga

mbeturinat e hedhura, në rast se e paditura nuk e rregullon kanalizimin atëherë të detyrohet që paditësit t'ia kompensoj për çdo vit shumën nga 9.246 euro për periudhën 99 vite ashtu siç është vlerësuar në mendimin dhe konstatimi nga ana e ekspertit vlerësues H.M..

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës gjyqësore për padi vlerën prej 1.000 euro , në emër të ekspertizës gjeodezike shumën prej 500 euro, për ekspertizë të vlerësimit të pronës 150 euro , për përpilim të padisë shumën prej 208 euro si dhe për 3 seanca të mbajtura për secilën veç e veç shumën prej 270 euro të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, nën kërcënimit e përmbarimit.

I autorizuari i të paditurës në fjalën e tij ka deklaruar se edhe më tutje mbetet pranë përgjigjes, thëniet e cekura në seancat e kaluara duke shtuar se nga provat e administruara, dhe atë ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë u konstatuan dy momente kryesore të cilat objektivisht dëshmojnë pa bazueshmërinë e kërkesëpadiës së paditësit, dhe atë u vërteua se e paditura asnjëherë nuk ka ndërmarr asnjë veprim të drejtë për drejtë në asnjërën prej paluajtshmërive të paditësit dhe dëmi i pretenduar që i është shkaktuar paditësit rrjedhë nga kanalizimi e cila në tërë gjatësinë e saj dhe tërë sipërfaqen e saj shtrihet në ngastrën nr. 145-0 e cila është pronë komunale, andaj në rastin konkretë ka theksuar se nuk mund të ketë asnjë dyshim se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston asnjë raport juridik lidhur me dëmet pretenduara qoftë të kontraktuara apo jo të kontraktuara .

Burimi i dëmeve të pretenduara gjendet në pronën dhe posedimin dhe pronësinë e personit të tretë, në këtë rast Komuna e Ferizajt cila ka dhënë pëlqimin e plotë të saj, që e paditura ta hudhë dheun në ngastrën e saj, nuk i ka treguar asnjëherë për ekzistimin apo jo të shakteve dhe kolektorëve, nuk e ka mbikëqyr asnjë herë hedhjen e sasisë së dheut, dhe për më tepër për plotë 5 vite nuk ka ndërmarr asnjë veprim në kuptim të riparimit të dëmeve eventuale në kanalin e kanalizimit në pronësinë e saj.

Njëherit ka shtuar se edhe nën supozimin se dëmet ekzistojnë paditësi ato mund ti kërkoj nga Komuna Ferizajt e cila pastaj në bazë të parimit të regresit, eventualisht mund ti kërkoj nga e paditura, andaj dhe në rastin konkretë e paditura nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për dëmet e pretenduara dhe se ajo përgjegjësi është në anën e Komunës së Ferizajt, pasi që është edhe e paditura edhe sikur të kishte pasur për qëllim ti riparonte dëmet e pretenduara nuk do të kishte mundësi që të futet në ngastrën ku gjendet vija e kanalizimit pa pëlqimin e pronarit të saj juridik komunës.

Sa i përket ekspertizës vlerësuese, të njëjtën e ka kundërshtuar në tërësi pasi që eksperti nuk e ka bazuar askund mendimin e tij, pasi që fitimi i humbur përllogaritet në bazë të kulturave

bujqësore që kanë qenë të mbjella në ngastrën lëndore para se dëmi të shkaktohet, e jo në bazë të faktit se për çfarë kultura bujqësore ngastrat lëndore qenka në të rehatshme të mbillen.

Ka kërkuar nga ana e gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, duke e detyruar paditësin që të paditurës t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës dhe atë për 3 përfaqësime nga 270 euro, dhe për një parashtresë shumë prej 208 euro apo shumë totale prej 1.018 euro.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: U lexua procesverbali i datës 26.11.2018, në të cilën është bërë administrim i provave, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të gjeodezisë E.P.e dt.25.06.2019 të bashkangjitur fletën poseduese dt.28.06.2019 si dhe skicën e majtës si dhe fotografitë pjesë e ekspertizës gjeodezike, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të vlerësimit të pronës H.M. dt.06.08.2019, procesverbali i datës 16.09.2020 në të cilën është dëgjuar eksperti H.M..

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata me rastin e vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, konsideron se e njëjta bazohet në provat e administruara dhe përmes procesverbalit të përpiluar nga ana e Inspektoratit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 355/036 dt.26.03.2018, përmes të cilit gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura me rastin e rregullimit të Autostradës Prishtinë-Shkup "Arbën Xhaferi" ka bërë hedhjen e një sasi të madhe dheu në NK.nr.145-0 pronë e Komunës së Ferizajt, përmes të cilës ka bllokuar një pjesë të lumit respektivisht të rruga ku ka vendosur një gyp të vogël i cili nuk e përballon sasinë e ujit në të cilën derdhet edhe kanalizimi i fshatit Surqin dhe Babush, me të cilin veprim i shkaktuar dëme të konsiderueshëm në pronat e paditësit.

Se paditësit i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm, në pronat e tij pas këtij veprimi të paditurës, kjo vërtetohet edhe përmes fotove të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës ku shihet pronat e paditësit para se ti shkaktohej dëmi nga foto numër 1 deri te foto nr.11, të cilat janë toka të punueshme (të mbjellura), ku dhe pas dëmi siç shihet nga foto numër 12 deri te foto numër 40 ku janë të mbulura me ujë për shkak të pamundësisë së derdhjes së ujërave në degën e Lumin Nerodimka dhe daljes së ujërave të zeza mbi shaktet e kanalizimit siç shihet në fotot numër 13 dhe 14 si dhe foto të cilat janë pjesë e ekspertizës së gjeodezisë dhe asaj të vlerësimit të paluatjshmërisë.

Se deri te ky dëm ka ardhur me veprimet e të paditurës kjo është vërtetuar edhe përmes nxjerrjes së provë me ekspertizë të lëmisë së gjeodezisë përmes të cilës gjykata fillimisht e ka vërtetuar se paditësi a është pronar i pronave në të cilat pretendon se i është shkaktuar dëmi material ku eksperti ka deklaruar se paditësi është pronar i pjesës dërmuese të këtyre pronave e të cilat i ka specifikuar hollësisht në ekspertizë si dhe është konstatua se mes këtyre pronave është prona e cila evidentohet në emër të Komunës së Ferizajt ku dhe është i instaluar kanalizimi i fshatit Surqin, Babush dhe i cili ka pasur derdhje në degën e lumit Nerodimka, ku shihet se ujërat e zeza dalin mbi shaktet e kanalizimit dhe derdhen në pronat e paditësit e të cilat e bëjnë të pa përshtatshme (të pamundur) që të punohen.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit material në emër të fitimit të humbur ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në dispozitat e nenit 136, 137, 140 dhe 173 të LMD-së.

Gjykata kompenzimin e dëmit në emër të fitimi të humbur që i është shkaktuar paditësi në kompleksin e pronave pronar i të cilave është dhe atë NK.nr.271-1 në sipër prej 1773m², NK.nr.275-0 në sipër prej 6228m², NK.nr.277-0, në sipër prej 1499m², NK.nr.282-0, në sipër prej 3018m², NK.nr.283-0, në sipër prej 3217m², NK.nr.302-0, në sipër prej 3724m², NK.nr.305-0, në sipër prej 4511m², NK.nr.310-0 në sipër prej 2880m², NK.nr.311-0 në sipër prej 2115m², NK.nr.312-1, në sipër prej 2041m², NK.nr.313-0, në sipër prej 4080m², NK.nr.314-0 në sipër prej 3600m², NK.nr.315-0 në sipër prej 1800m², NK.nr.316-0 në sipër prej 1930m², NK.nr.317-0 në sipër prej 5720m², NK.nr.318-0 në sipër prej 5112m², NK.nr.320-0 në sipër prej 4670m², NK.nr.321-0 në sipër prej 2212m², NK.nr.322-0 në sipër prej 4847m², të gjitha vendi i quajtur “Pojatë” ZK Babush i Serbëve, NK.nr.441-0 në sipër prej 2086m², NK.nr.444-0 në sipër prej 2001m², NK.nr.445-0 në sipër prej 11616m², NK.nr.446-0m², në sipër prej 2711m², NK.nr.448-0, në sipër prej 6179m², NK.nr.449-0, në sipër prej 3030m², NK.nr.450-0 në sipër prej 3269m², NK.nr.467-0, në sipër prej 6959m², NK.nr.468-0 në sipër prej 2654m², NK.nr.469-2 në sipër prej 3633m² vendi i quajtur “Kallamishte” ZK Babush i Serbëve dhe NK.nr.470-2 në sipër prej 4059m² vendi i quajtur “Kalamçiqi” ZK Babush i Serbëve, të cilat prona gjenden në dy anët e NK.nr.891-0 e cila pronë evidentohet në emër të Komunës së Ferizajt rrugë publike në për të cilën kalojnë edhe gypat e kanalizimit të fshatit Surqin dhe Babush të cilat gypa pastaj kalojnë nëpër pjesën e NK.nr.145-0 pasuri shoqërore pronë e Komunës së Ferizajt dhe këta gypa të kanalizimit rrjedha e të cilëve derdhet

në degën e lumit Nerodimka, siç është vërtetuar përmes daljes së gjykatës në vendin kontestues dhe në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të gjeodezisë E.P. të datës 25.06.2019.

Eksperti i gjeodezisë E.P. nuk është dëgjuar në seancë edhe pse është detyrim të dëgjohet për të dhënë sqarime siç parashihet me nenin 362.1 të LPK-së, por kjo është bërë për shkak se që palët në seancën e datës 16.09.2020, kanë hequr dorë nga dëgjimi i tij, për të dhënë sqarime, për çka edhe për gjykatën ekspertiza ka qenë e qartë dhe nuk ka pasur nevojë të ftohet për të dhënë sqarime.

Andaj, gjykata sa i përket dëmit material-fitimit të humbur e bazuar në nenin 173 të LMD-së e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë vetëm për periudhën kohore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, (tri vite) ia ka njohur shumën për çdo vite nga 9.246,00€, (nëntë mijë e dyqind e katër dhjetë e gjashtë euro), apo shumën e përgjithshme prej 27.738,00€ (njëzet e shtatë mijë euro e shtatëqind e tridhjetë e tetë euro), siç është vërtetuar përmes nxjerrjes së provës me ekspertizës të vlerësimit të dëmit bërë nga eksperti H.M. e datës 06.08.2019, sqarimeve të dhëna në seancën e datës 16.09.2020, sipas të cilit ekspert deri te lartësia e dëmit për çdo vite që i është shkaktuar paditësit dhe që mund ti shkaktohej edhe në të ardhmen ka ardhur duke marr për bazë tri llojeve të kulturave bujqësore p.sh. grurë, misër dhe janxhe të cilat janë të përshtatshme për kultivimin e tyre në ato prona, e që eksperti nuk ka marr për bazë lloje tjera të kulturave bujqësore e për mbjelljen e tyre boni-teti i këtyre pronave është më pak i përshtatshëm siç është lakra, patatja etj, e të cilat po ti merrte për bazë mbjelljen me këto kultura bujqësore lartësia e dëmit do të ishte shumë më e madhe, kurse pjesën tjetër të cilën e ka kërkuar që për çdo vit nga 9.246 euro në periudhë prej 99 vite ia ka refuzuar si të pa bazuar, pasi që nuk është provuar se e edhe më tutje do ti shkaktohej dëm paditësit pasi që konsiderohet si e ardhme e pasigurt andaj dhe për një formë të dëmit nuk mundet e paditura me u detyruar që ta përmbush, në këtë kohë, pasi që i mungon baza juridike por kjo nuk do të thotë se paditësi të mos paraqet padi të veçantë, andaj gjykata ia ka falur besimin ekspertizës së ekspertit vlerësues H.M. si objektive dhe profesionale për pjesës që e ka vlerësuar dëmin për vitet 2018, 2019 dhe 2020, kurse për pjesën tjetër të cilën e ka kërkuar paditësi për çdo vit nga 9.246 euro gjykata meqenëse për këtë periudhë i ka munguar baza juridike e kërkesëpadisë, andaj dhe kjo ekspertizës për këtë pjesë ka qenë e parëndësishme.

Andaj, gjykata sa i përket dëmit që ia ka njohur paditësit është bazuar në nenin 136, Baza e përgjegjësisë ku thuhet “Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij” kurse në 137 të LMD-së Dëmi thuhet “Dëmi

është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengim i rritjes së saj (fitim i humbur)”...etj, në rastin konkretë dëmin e zakonshëm për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, e të cilin gjykata ia ka njohur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që paditësit i është zvogëluar pasuria respektivisht paditësi është penguar në rritjen e saj.

Se e paditura është përgjegjës për dëmin e zakonshëm kjo vërtetohet edhe përmes dispozitës ligjor të nenit 140 të LMD-së Ekzistimi i fajësisë ku thuhet “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, në rastin konkretë e paditura edhe pse e ka pasur pëlqimin e Komunës së Ferizajt që në pronën e saj të vendos sasinë e dheut të gjermuar nga traseja e autostradës, Prishtinë Shkup “Arben Xhaferi” me rastin e hedhjes-vendosjes të sasisë së dheut në NK.nr.145-0 pronë e Komunës së Ferizajt nga mos kujdesi i duhur e ka bërë bllokimin e pjesës së kanalizimit që vjen nga fshati Surqinë dhe Babush që derdhet në degën e lumit Neredimka, andaj në rastin konkretë edhe pse e paditura ka pasur pëlqimin e Komunës që të vendos sasinë e dheut kjo nuk do të thotë me i shkaktuar dëme personit të tretë, pronës fqinje në rastin konkretë pronave të paditësit.

Andaj, meqenëse e paditura ka bërë vendosjen e sasisë së dheut në NK.nr.145-0, e cila nuk ka qenë kontestuese përmes të cilës është ardhur deri te bllokimi i kanalizimit e njëjta është edhe përgjegjëse fillimisht me ia kompensuar dëmin paditësit dhe me bërë kthimin në gjendjen e mëparshme, gjendje e cila ishte deri para shkaktimit të dëmit, se e paditura është përgjegjëse kjo është vërtetuar edhe përmes procesverbalit të përpiluar nga ana e Inspektoratit të Komunës së Ferizajt të datës 26.03.2018, ku në pjesën e fundit është detyruar e paditura që ta rregulloj shtratin e lumit në mënyrë që të evitohet dëmet e mundshme dhe të kthej gjendjen e mëparshme, mirëpo e cila gjendje nuk është rikthyer deri me datën kur gjykata e ka nxjerr provës përmes daljes në vendin kontestues me anë të ekspertit të lëmisë së gjeodezisë.

Se e paditura është përgjegjëse të veproj sipas pikës III të dispozitivit kjo vërtetohet edhe me dispozitën ligjore të nenit 6 të LPDTS-së Ndalimi i keqpërdorimit ku në pa.1 thuhet “Keqpërdorimi i të drejtave sendore është i ndaluar”, kurse në par.2 thuhet “Të drejtat sendore keqpërdoren, nëse përdoren ekskluzivisht ose qartas për t’i shkaktuar dëm personave të tjerë ose pasurive të tyre”, andaj në rastin konkretë e paditura duke vendosur sasinë e dheut në NK.nr.145-0 me pëlqimin e Komunës së Ferizaj e ka keqpërdorur të drejtat sendore, e cila gjë është e ndaluar dhe duke keqpërdorur këtë të drejtë i ka shkaktuar dëm personave të tjerë në këtë rast paditësit në pronat e tij, si dhe edhe me nenin 78 të këtij ligji ku rregullohet e drejta fqinjësore ku ekziston edhe detyrimi për përkujdesje ku në par.1 të këtij neni thuhet “Pronarët e

paluajtshmërive fqinjë janë të detyruar që ti marrin parasysh të drejtat dhe interesat e fqinjëve të tyre dhe të drejtat e tyre t'i ushtrojnë ashtu që të mos cenohen apo dëmtohen të drejtat e fqinjëve të tyre”, andaj duke u bazuar në këtë e paditura është përgjegjës që ta rikthej gjendjen e mëparshme që mos ti shkaktohej edhe më tutje dëm paditësit në pronat e tij.

Pretendimi i të paditurës se i mungon legjitimiteti i palës në procedurë por përgjegjës do të mund të ishte Komuna e Ferizajt pasi që prona nga është shkaktuar dëmi paditësit është në emër të Komunës nuk qëndron, pasi që e paditura e ka vendosur sasinë e dheut në pronën e Komunës me pëlqimin e saj andaj dhe e njëjta është dashur me pasur kujdes të shtuar që mos ti shkaktohej dëme personave të tretë e që kjo është e rregulluar edhe me nenin 9 të LMD-së Ndalimi i shkakimit të dëmi ku thuhet “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t'i shkaktoj dëm tjetrit”, në rastin konkretë e paditura është dashur të përmbahet që me rasti e vendosjes së sasisë së dheut të mos i shkaktoj dëm tjetrit në rastin konkretë paditësit, andaj e paditura është përgjegjës për dëmin e shkaktuar e jo siç pretendon Komuna Ferizaj.

Sa i përket pretendimit se edhe po të dojë e paditura të largoj sasinë e dheut nga prona NK.nr.145-0 ka theksuar se nuk ka mundësi pa e marr pëlqimin e Komunës së Ferizajt e cila është pronare dhe poseduese e saj, ky pretendim nuk qëndron pasi që e paditura me anë të procesverbalit të lëshuar nga ana e Inspektoratit të Komunës së Ferizajt lart cekur është detyruar që të intervenoj përmes të cilës ta funksionalizoj kanalizimin të cilin e ka bllokuar dhe mos ti shkaktoj në të ardhmen dëm në pronat e paditësit por një gjë të tillë nuk e ka bërë edhe pse përmes të cilës vërtetohet se e ka pasur pëlqimin të hy në pronën e Komunës dhe të rregulloj dëmin e bërë, andaj gjykata konsideron se me këtë pretendim e paditura ka për qëllim vetëm që ti shmangët përgjegjësisë, se nuk është edhe e domosdoshme të merret pëlqimi në rastet kur ekziston rreziku i shkakimit të dëmi kjo parashihet edhe me nenin 20.2 të LPDTS-së ku thuhet “Pronari i një sendi të luajtshëm ose i një paluajtshmërie nuk ka të drejtë të ndalojë të tjerët për ushtrimin e ndikimeve mbi këtë pronë nëse kjo është e domosdoshme për shmangien e rrezikut të pritshëm, përderisa rreziku është proporcionalisht më i madh në krahasim me dëmin që i shkaktohet pronarit, kurse në par.2 Pronari mund të kërkojë kompensim për çdo dëm të shkaktuar”, andaj edhe përmes kësaj dispozite ligjore nuk ka qenë e domosdoshme ashtu siç pretendon e paditura se duhet ti merret pëlqimi nga pronarja e NK.nr.145-0 që është Komuna Ferizaj pasi që është vërtetuar se me intervenimin e bërë do të shmangej rreziku i pritshëm i dëmit që do të shkaktohej.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marr parasysh edhe pretendimin e përfaqësuesit të paditurës e të cilat kanë qenë pjesërisht të bazuara, kjo duke u nisur nga fakti që gjykata sa i përket kompenzimit të dëmit të cilën e ka kërkuar paditësi që të detyrohet e paditura që në të ardhmen për çdo muaj të paguaj shumën nga 9.246 euro në periudhë prej 99 vite në sikurse në pikën IV të dispozitivit e ka refuzuar, përveç kësaj ka marr parasysh edhe pretendimet tjera por nuk ka pasur bazë për të vendosur ndryshe.

Gjykata bazuar në neni 382 të LMD-së, paditësit ia ka njohur kamatën ligjore prej 8% nga data 12.10.2020 deri në pagesën definitive.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, andaj e paditura obligohet që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 1,768€ dhe atë për përpilim të padisë 208€, për përfaqësim në tri seanca për secilën nga 270€, për taksën gjyqësore për padi 100€, për ekspertizës të gjeodezisë 500€, për ekspertizë të vlerësimit të dëmit 150€ pjesa tjetër është refuzuar si e pabazuar.

Sa i përket kërkesë në emër të takës gjyqësore për padi të cilën e ka kërkuar paditësi në shumë prej 1.000€, gjykata e ka refuzuar pasi që këtë taksë paditësi e ka bërë në emër të taksë gjyqësore të cilën e ka kërkuar për masën sigurisë e cila i është refuzuar andaj me këto shpenzime nuk mundet e paditura me u ngarkuar.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.1013/18 dt.26.10.2020.

Gjyqtari
Alban Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.